

PËRDORIMI DHE FUNKSIONET E PASKAJORES

Hyrje

Në sistemi foljor të shqipes, krahas formave të shtjelluara sintetike e analitike janë përftuar edhe një numër formash të pashtjelluara. Në bazë të mundësisë apo të pamundësisë për të ndryshuar, sipas vetës e numrit, format gramatikore të foljes ndahen në dy grupe të mëdha: në forma të shtjelluara dhe forma të pashtjelluara. Në grupin e parë, hyjnë format e ndryshme gramatikore të kohëve të mënyrës dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore, kurse në grupin e dytë, hyjnë format e ngurosurat të pjesores: *larë*, të përcjellores: *duke larë*, të formës së pashtjelluar mohore: *pa larë*, si edhe format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *më të larë*. Nga këto, vetëm njëra është sintetike, kurse të tjerat janë analitike. Pra, kemi trajtuar përdorimin e paskajores nga njohës të ndryshëm të gjuhës shqipe, duke parë format me të cilat shfaqet në përdorim dhe funksionet e saj.

Grupimi i formave të pashtjelluara të foljes

Gjuhës së sotme shqipe, bazuar në *Gramatikën* e Akademisë, i njihen pesë forma të pashtjelluara të foljes, p.sh.: *bërë*, *duke bërë*, *pa bërë*, *për të bërë* dhe *me të bërë*. Paskajorja analitike e tipit *me punue* konsiderohet nga *Gramatika* e Akademisë si paskajore e të folmeve gege (2002: 299). E folmja e Rugovës i njeh të gjitha trajtat e infinitivit gegë. (Gjinari, 1975: 157). Në radhë të pare, përdorim të dendur në këtë të folme, ka tipi i paskajores gege me pjesëzën *me*, e tipit: *me la:*, *me ble:dh*, *me za:n* etj. Haset dendur edhe paskajorja e tipit *për me la:*, *për me ble:dh*, *për me vo:jt*, *për me za:n* etj. Si në të

* Mësimdhënëse e lëndës "Gjuhë shqipe". Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.

folmen e Kelmendit dhe të Hotit. (Shkurtaj, 1976:389). Kështu, në të folmen e Shkrelit, sipas Bahri Becit (1971: 301), paskajorja del me dy forma themelore: a) *me + pjesore (me urdhnuë)* dhe b) *për me + pjesore (për me urdhnuë)*. Sipas Gjovalin Shkurtajt (1982: 144), te e folmja e Rranxave të Mbishkodrës, paskajorja formohet me *me + pjesore, me punue*.

Paskajorja analitike e tipit *me punue*

Paskajorja analitike e tipit *me punue* nuk është përfshirë në shqipen e sotme standarde dhe duke mos qenë pjesë e standardit, ajo edhe nuk trajtohet nga Gramatika e Akademisë. Aty vetëm thuhet se karshi formave të tjera të pashtjelluara të foljes që ndërtohen mbi bazën e pjesores, futet edhe forma e tipit *me punue* që përdoret si paskajore në të folmet e gegërishtes (2002: 299). Sinkronikisht, paskajorja *me punue* zërthehet në pjesëzën parafjalore *me* dhe në pjesoren e foljes (*me pun-u/-ue* dhe jo *me punuar*). Edhe për pjesoren në përbërje të paskajores sintetike janë dhënë mendime të ndryshme. Riza (1996: 126) mendon që edhe shqipja dikur ka pasur një paskajore sintetike si gjuhët e tjera indoevropiane. Ai thotë se pjesorja e sotme e shqipes dikur ka qenë paskajore, mirëpo me kalimin e kohës pakajorja e lashtë (sintetike) dilte edhe në funksionet e pjesores. Kështu që, në këto rrethana, për t'u dalluar pjesorja nga paskajorja, kjo e fundit u shoqërua me parafjalën *me*. Mundësinë që pjesorja e sotme të ketë pasur vlerën e një paskajoreje e përjashton Bokshi (1998: 199), duke u nisur nga raporti i pjesores me foljet modale *duhet, do* dhe *mund*. Përderisa në gjuhët neolatine perëndimore këto folje ndiqen nga infinitivi, në gjuhën shqipe nuk ndodh kjo, nëse e marrim pjesoren e sotme si një infinitiv sintetik. Lidhur me ekzistencën e një paskajoreje sintetike në gjuhën shqipe janë shprehur edhe Pedersen (te Bokshi, 1998: 7), Topalli (2011: 1074) etj.

Paskajorja *me punue* karakterizohet si paskajore geqe. Sipas Badallajt (2001: 401), paskajorja perifrastike shtrihet jo vetëm në gegërishten e Shqipërisë Veriore dhe në atë të Shqipërisë së Mesme, por në gjithë Kosovën, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në trevat shqiptare në jug të Serbisë. Në shqipen standarde, me funksione të kufizuara të paskajores, del ndërtimi i tipit *për të punuar*, ose paskajorja zëvendësohet me lidhoren *me punue -të punosh*. Sipas

disa gjuhëtarëve, paskajorja *me punue* ka qenë e mbarë shqipes. Bokshi (2011: 159) thotë se paskajorja *me +* forma e pjesores pësore e së kryerës është krijuar para formimit të mbiemrit të nyjshëm, që do të thotë se ishte e tërë shqipes. Ai thotë se krijimi i kësaj forme nuk e pengoi përdorimin e mënyrës lidhore që ishte para kësaj forme infinitivale, përveç në disa raste tepër të pakta ku nuk ishin të zëvendësueshme nga njëra-tjetra, lidhorja dhe paskajorja ishin variante të lira. Ndërsa daljen nga përdorimi të kësaj forme në toskërishte, ai e sheh si ndikim të greqishtes së mesme, e cila e kishte humbur paskajoren dhe e kishte zëvendësuar atë me lidhoren.

Edhe F. Altimari thotë se paskajorja e llojit *me + pjesore*, që sot trajtohet si geqe për shkak të shtrirjes së saj, duhet të ketë qenë më parë pjesë përbërëse e sistemit foljor të mbarë shqipes (2010: 113). Si dëshmi për këtë ai jep përdorimin e kësaj paskajoreje, edhe pse gramatikalisht të ngurosur, në gjuhën e folur të arbëreshëve të Italisë, si p.sh.: *vjen me thënë, vjen mu rarë* etj. (te Altimari, 2010: 104-105). “Infinitivi me *me* është panshqiptar dhe përdorimi i infinitivit me *me* rrjedh prej përdorimit të tij më prepozicionin *pa*”, – thotë Riza (1996: 125).

Zëvendësimi i paskajores nga format e tjera

Mosprania e paskajores apo zëvendësimi i saj me lidhoren konsiderohet si tipar i gjuhëve ballkanike. Badallaj (2012: 545) thotë se ky mendim është i pranueshëm për greqishten e re, për bullgarishten, maqedonishten, rumanishten, por jo edhe për shqipen, serbishten dhe kroatishten.

Për humbjen e paskajores në toskërishte, Bokshi thotë se duhet të ketë ndikuar greqishtja e re (e cila e kishte humbur paskajoren). Një element tjetër ndikues mund të ketë qenë edhe zgjerimi i formës së pjesores në toskërishte. Pjesorja fillimisht ka qenë e shkurtër, në mbarë shqipen (këtë e dëshmon pjesorja në format e habitores), mirëpo me krijimin e mbiemrave prejpjesorë, toskërishtja formën e mbiemrit prejpjesor e kaloi edhe në pjesoren në përdorim foljor, p.sh.: *i pre-rë*, ndërsa gegërishtja e ruajti dallimin ndërmjet formës së pjesores nga ajo e mbiemrit prejpjesor: *ka la-i la-m, ka ardhë-i ardh-unë* etj., kështu që e vetmja formë e pjesores që mbeti e përbashkët në të dy dialektet është forma e foljeve apofonike në sonante: *vjelë*,

dalë, mbjellë, marrë dhe ato që përfundonin me *në - n*, si: *thënë, lënë (thanë, lanë)* etj., me dallim fonetik *a-ë* (1998: 161).

Paskajorja ka karakter të dyfishtë, emëror dhe foljor. Çabej mendon se paskajorja është një formim i periudhave historike të gjuhëve indoevropiane, sepse këtë ai e sheh si pjesë të kulturës (1986: 119). Ai thotë se infinitivi është një përfitim që lidhet me një farë përparimi kulturor, sepse ka lidhje me një mendim abstrakt dhe se është ajo formë foljore abstrakte e foljes, që në gjuhët primitive shumë herë nuk del. Infinitivi *“lidhet me një zhvillim të një mendimi, të një abstraksioni mendor, jep idenë e përgjithshme të foljes”*. Çabej thotë se duhet të ketë qenë një pjesore e një periudhe më të vjetër, një pjesore e substantivuar, pa nyjë të përparme. Domethënë forma *me shkru* është *“me të shkruemit”* (po aty, 120). Me paskajoren jepet ideja e një veprimi, pa iu referuar askujt konkretisht me atë veprim. Pikërisht në këtë pikë qëndron dallimi ndërmjet paskajores dhe zëvendësimit të saj me lidhoren. Siç thotë Paçarizi (2011: 59), lidhorea ka referencë vetore dhe ajo kur përdoret për të zëvendësuar paskajoren i referohet një personi në vetën e dytë, apo disa personave në vetën e dytë. Kështu, vlera e konceptit foljor të dhënë nga lidhorea nuk zgjerohet më shumë sesa në një apo disa bashkëbisedues p.sh.: *Me këndue është mirë / Të këndosh është mirë*. “Infinitivi me *me* shtrihet në dy të tretat e arealit shqipfolës”, - vlerëson Paçarizi. (2011: 61). Edhe Nuhi Veselaj (2006:31) e sheh si joadekuat zëvendësimin e paskajores me lidhoren, pasi ato dallojnë nga njëra - tjetra si nga përmbajtja, ashtu edhe nga forma. Ai thotë se lidhorea si mënyrë më vete shpreh modalitetin e mundshmërisë dhe format e saj ndryshojnë sipas kohëve, numrit e vetave, kurse në anën tjetër, paskajorja del si trajtë statike dhe shpreh një abstraksion të lartë, të cilin nuk mund ta zëvendësojnë trajtat e lidhores. Prandaj, planëzimi për heqjen a zhdukjen e paskajores me zëvendësimin e saj me lidhore, doli i pazbatueshëm, vlerëson Veselaj. Mënjanimin e paskajores dhe zëvendësimin e saj me lidhoren, Riza e vlerëson si të pabesueshëm. Ai thotë se *“...paskajorja me të vërtetë është një mënyrë foljore kaq e rehatshme në krahasim me lidhoren, saqë mënjanimi i saj me të mirë në trajtën e lidhores është i pabesueshëm pa ndonjë nevojë shumë serioze”* (1998:54).

Koncepti i Josephit për infinitivin ballkanik (Sejdiu-Rugova, 2013:139)

Josephi mendon se është e kotë të flitet për humbje të infinitivit në gjuhët e Ballkanit, pa e shtjelluar esencën e këtij fenomeni gjuhësor në secilën nga këto gjuhë veç e veç. (Joseph, 1983:6). Brian Josephi përpiqet të japë një zgjidhje duke e theksuar rëndësinë e kombinimit universal të tipareve gramatikore të shtjellueshmërisë në disa gjuhë, bashkë me caktimin e tipareve dalluese të kësaj shtjellueshmërie, siç janë: shënjimi vetor, shënjimi kohor apo në numër, në çdo gjuhë veç e veç. Josephi konsideron se shqipja e sotme i përmban disa trajta foljore që korrespondojnë me trajtat e shtjelluara të greqishtes, si dhe me konstruktionet foljore infinitivale të gjuhëve të tjera evropiane. Trajta të tilla mund të jenë disa.

Mundësitë e inkuadrimit të paskajores së tipit *me punue* në shqipen standarde

Kohët e fundit paskajorja me *me* po përdoret gjithnjë e më shumë edhe te folësit e gjuhës standarde apo edhe në emisione të ndryshme në televizione, e sidomos në të folurit e shpejtë. Bokshi (2001: 160) thotë se “*paskajorja duke qenë formë foljore pa vetë e pa numër është e seleksionueshme më me lehtësi se lidhorja e cila është e ngarkuar me këto kuptime*”. Ai thotë se format e pjesores që kanë mbetur të përbashkëta për të dy dialektet e lehtësojnë përdorimin e paskajores me *me* brenda gjuhës së folur standarde: *me vjelë, me marrë, me dalë* etj., ndihmuar edhe nga format e pranuar më parë në toskërishte si *me thanë, me qenë (do me thënë, me qenë se, me qenë që)*(Cit. Binaj:2014, 285). Bokshi thotë se paskajorja mund të futet në shqipen standarde si variant i lirë me lidhoren. “*Duke u bërë pjesë e sistemit foljor të shqipes standarde, paskajorja nuk imponon ndryshimin e formës së pjesores të kësaj gjuhe, sepse kjo formë është e mbëshetur nga dialekti toskë në të gjitha funksionet e saj, përveç të tjerash, edhe me mënyrën e formimit të mbiemrit të nyjshëm prejpjesor drejtpërdrejt nga pjesorja, edhe me krijimin e emrave asnjans prejpjesorë: të vepruarit, të ushqyerit etj., edhe brenda formave të ndryshme foljore e emërore*”. Kështu, duke e pranuar në standard paskajoren do të përshpejtohej përdorimi i çlirshëm i saj, – shton Bokshi (2001: 163).

Për mundësitë e integritit të paskajores me *me* në shqipen standarde ka folur edhe Sh. Munishi(2011: 200). Si mundësi për futjen e paskajores në shqipen standarde ai sheh ngritjen në normë të një pjese të madhe të pjesoreve të shkurtra, krahas atyre të zgjeruara, pra funksionimin paralel të këtyre formave. Munishi propozon që pjesorjet që dalin me *ur* (*gjetur*) të futen në standard si forma me mbaresën ë (*gjetë*) dhe në këtë mënyrë kësaj forme, (*me gjetë*) me kohë do t'i krijohej hapësirë e pranueshmëri që edhe pjesoret e tjera të shkurtra të futen dhe të pranohen më lehtë në shqipen standarde. Edhe Julie May - Kolgjini thotë se "*përfshirja e paskajores nuk do ta pengonte standardin ekzistues; përkundrazi vetëm do ta zgjeronte atë, ta ngrinte në një nivel më të pasur, i cili do të ishte user - friendly duke lejuar barazinë në prestigj për të gjithë folësit e shqipes që të shprehin mendimet e tyre shumë më lehtësisht se me standardin ekzistues*" (2011: 220).

Funksionet e paskajores së tipit *me punue*

Paskajorja e tipit *me + pjesore*, del me funksione e përdorime të shumta sintaksore. Paskajorja e këtij tipi shpreh një proces në mënyrë të përgjithshme: ka krijuar kategorinë gramatikore të diatezës (*me ba: me u ba*); në fjali të aspektit mohor merr pjesëzën *mos*; është e aftë jo vetëm për të qenë fjalë bosht e një togfjalëshi me marrëdhënie kundrinore e me marrëdhënie rrethanore, si edhe çdo trajtë vetore e foljes, por edhe për të ndërtuar fjali të pavarura pyetëse, nxitëse e thirrmore, - thotë T. Kelmendi(2010: 46). Paskajorja del edhe me një formë të mbipërbërë me kuptimin e së kryerës, si: *me pas la*, në kundërvënie me të cilën forma *me la* quhet kohë e tashme.

Ndërtimet më të rëndomta në të cilat del paskajorja janë ndërtimet me paskajore të varur. Kështu, ajo del zakonisht në funksion kryefjalor, kundrinor, përcaktor, kohor, mënyror, rrjedhimor, kushtor, lejor dhe krahasor. Më rrallë haset funksioni i saj kallëzuesor e përcaktor - kallëzuesor që del vetëm në ndonjë ndërtim të veçantë dhe mund të trajtohet si shkakor ose më saktë, shkakor - kundrinor, si: *M'ka plasë zemra me t'pa!* (Kelmendi, 2010: 52). Edhe Demiraj (1988: 959) ia njuh pothuajse këto funksione paskajores. Në fjali të varur, ai thotë se paskajorja del me funksion kryefjalor, kundrinor, kallëzuesor, përcaktor, qëllimor, kushtor,

rrjedhimor e krahasor, si dhe pas foljeve modale *mund* e *duhet* si dhe foljeve me vlerë aspektore që shënojnë fillimin, vazhdimin ose mbarimin e veprimit. Ndërsa në fjali të pavarura ndeshet nëpër fjali a) pyetëse dhe b) urdhërore. P. sh. a) *Unë nandë qese ku me i marrë?*; b) *Me thanë të vërtetën për gjithë to e jo rrenën*. Me trajtimin e përdorimit e të funksioneve të paskajores është marrë edhe Fiedleri (1987: 179). Ai paraqet paskajoren geqe në fjali kryesore me përdorim voluntativ (para së gjithash imperativitet, optativitet dhe admisivitet) dhe në fjali pyetëse që shprehin vullnet apo polemikë.

Edhe Fiedleri thotë se paskajorja haset më dendur në tipat e fjalive të varura. Në fjali të varura, paskajorja del si pjesë e një predikati kompleks foljor, si përfaqësuese e një kundrine të drejtë, del në përdorim me foljet modale dhe me folje që shprehin një fazë të veprimit (foljet aspektore). Paskajorja, sipas Fiedlerit, del edhe në funksion kryefjalor, kohor para shprehjes *para se*; del në përdorim shkakor me shprehjen *me qenë se*, si përfaqësuese e fjalive lejore me nuanca të ndryshme modale; përfaqësuese e fjalive të njëpasnjëshme konsektive; si përfaqësuese e fjalive finale kur paskajores i paravijet parafjala për; si përfaqësuese e fjalive krahasore me ndërtimin (*aq*) + *sa* + *paskajore* dhe si përfaqësuese e fjalive përcaktore, pas grupeve të caktuara të emrave.

Format e pashtjelluara të ndërtuara mbi bazën e emrit prejfoljor asnjans

Format e pashtjelluara të këtij lloji historikisht trajtohen si të ndërtuara prej emrave prejfoljorë asnjans (të tipit *të larë*) duke u paravendosur pjesëzat *për dhe me*. Mirëpo, duke qenë se emrat prejfoljorë asnjans në gjuhën e sotme shqipe po vijjnë duke u pakësuar gjithnjë e më shumë, kurse format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *me të larë* mund të formohen për çdo folje, në gjuhën e sotme shqipe këto ndërtime interpretohen si forma të pashtjelluara që ndërtohen me bazën e pjesores me anë të pjesëzave *për të*, përkatësisht *me të*, thuhet në *Gramatikën* e Akademisë (2002: 299).

Edhe Riza sinkronikisht këto ndërtime i interpreton si *për të + pjesore*. Ai thotë se *për* rrjedh nga parafjala *për* me kuptim qëllimor, ndërsa *të* nga *nyja* e përparme *të* e numrit njëjës dhe e gjinisë asnjansë. Shndërrimin e këtyre elementeve në pjesëza

(d.m.th. në morfema ndihmëse pa asnjë vlerë leksikore) ai e sheh si të pabarabartë. Ai thotë se “ndërsa elementi i parë *të* ka humbur çdo lidhje kuptimore me nyjën e parme në të dy dialektet e shqipes, përkundrazi elementi për kuptimin qëllimor të parafjalës përkatëse është duke e humbur vetëm në toskërishte (që nuk njih tjetër paskajore inovuese) e jo njëherazi edhe në gegërishte (ku ndodh e kundërta)” (1997:208). Autorë të tjerë, si Çeliku (2000: 46); Fiedleri (1987: 183); Demiraj (1988: 977); Topalli (2011: 1084) etj., e japin edhe ndërtimin *një të bërë*, i cili për nga funksionet sintaksore është i ngjashëm me *me të bërë*, mirëpo përdoret shumë më rrallë. Ndërtimet e tilla të formave të pashtjelluara mbi bazën e një emrin prejfoljor, Çeliku i trajton si gerund (2000: 44). Ai thotë se forma e pashtjelluar e gerundit shpreh emërtim të veprimit e zotëron karakteristika të foljes e të emrit, por edhe të ndajfoljes. “Gerundi i shqipes shfaqet në dy trajta rasore: *të bërë*, *së bëri*” – shton ai (po aty).

Forma e pashtjelluar e tipit për të larë

Forma e pashtjelluar e këtij tipi përdoret në shqipen standarde si zëvendësim i paskajores. Në *Gramatikën* e Akademisë (2002: 339) thuhet se kjo formë nga përmbajtja kuptimore ka vlerë paskajoreje, pasi ajo shërben për të emërtuar një veprim si proces, pa iu referuar një vete të caktuar. Kjo formë mund të përdoret në diatezën veprorë e joveprorë, ashtu si edhe format e pashtjelluara, të ndërtuara mbi bazën e pjesores, mirëpo ndryshe nga ato, kjo formë nuk shpreh ndonjë kuptim kohor. Ndërtimi i tipit *për të punuar* nuk mund t’i përmbushë të gjitha funksionet e paskajores, prandaj edhe është quajtur formë analitike foljore me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara. “*Kësaj forme i mungojnë të gjitha përdorimet në fjalitë kryesore, si dhe në fjali të nënrenditura kryefjalore, kundrinore, kushtore, dhe lejore*”, – thotë Demiraj (1988: 984).

Funksionet e tipit për të larë

Sipas Fiedlerit (1987: 181) kjo formë (*për të larë*) përdoret edhe si përfaqësuese e fjalive rrjedhimore, me ç’rast e ashtuquajtura paskajore shpreh një pasojë që rezulton nga një kuantitet ose

kualitet i caktuar: *Drita e saj ishte e mjaftueshme për të zbuluar udhën. Në të folmet veriore, – thotë Demiraj (1988: 984), – forma e pashtjelluar në shqyrtim e prirë nga paskajorja me pjesëzën me e foljes kam, përdoret edhe në fjali të nënrenditura kushtore: Baba, me pasë për të na martue, ma parë më marton mue qi jam e madhja.*

Bibliografia

- Altimari, Françesko (2010). “Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë,” në: Çështje të studimeve diakronike të shqipes, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- Bokshi, Besim: *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, ASHAK, Botime të veçanta CX, Libri 45, Prishtinë, 2010.
- Bokshi, Besim (1998). *Paskajorja e shqipes (vështrim diakronik)*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- Bokshi, Besim (2011). *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe, Shqipja në etapën e sotme: Politikat e Përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Botimet Albanologjike, Tiranë
- Badallaj, Imri (2001). *Rreth paskajores në gjuhën shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 19, kryeredaktorë: akademik Rexhep Ismajli, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
- BUCHHOLZ, Oda/ FIEDLER, Wielfried (1987). *Albanische Grammatik*, Leipzig.
- Binaj, Kadire. (2015). *Paskajorja dhe ideologjia*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 32, kryeredaktorë: prof.dr. Bardh Rugova, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1986). *Studime gjuhësore*, VII, “Rilindja”, Prishtinë.
- Çeliku, Mehmet (2000). *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, SHBLU, Tiranë.
- Demiraj, Shaban (1974). *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika-Morfologjia)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i